

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR - MARS 2026

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	05.01.2025	Kërkesë për informacion mbi projektin "Restaurimi i çatisë dhe i fasadave të objektit ish prefektura e Vlorës".	08.01.2026	<p>Në vijim të adresimit të shqetësimit tuaj, sa i përket problematikave dhe degradimit të pasurisë kulturore me emrin "Ish prefektura e Vlorës", si pasojë e mos ndërhyrjes prej një kohe të gjatë, IKTK brenda fushës së kompetencës ju ka shprehur gatishmërinë që në bashkëpunim me DRTK Vlorë të kryej një inspektim në terren, me qëllim hartimin e një projekti restaurimi për këtë pasuri kulturore.</p> <p>Ashtu sikurse jeni në dijeni, inspektimi u realizuar në muajin korrik 2025 dhe nga ana e IKTK-se u hartua projekti i restaurimit me titull "Restaurimi i çatisë dhe i fasadave të objektit ish-Prefektura e Vlorës", Monument Kulture i Kategorisë së I-re, i cili u shqyrtua dhe u miratua në KKTKM me Vendim Nr. 519, datë 24.10.2025, duke e përmbyshur kështu angazhimin e mare.</p> <p>Lidhur me financimin e projektit të restaurimit, në shkresën Nr.1638/1 Prot., datë 15.11.2024, ju është komunikuar se pas hartimit dhe miratimit të projektit të restaurimit, ju mund të aplikoni për mbështetje financiare, në kuadër të programeve të financuara nëpërmjet buxheteve të qeverisjes qendrore apo vendore ose mund të vijoni me zbatimin e tij sipas parashikimeve ligjore.</p> <p>Për sa me sipër Ju informojmë se, financimi në mënyrë direkte i ndërhyrjeve konservuese/restauruese në pasuritë kulturore materiale, është jashtë fushës së kompetencës së IKTK-se.</p>	E plotë	Jo
2	06.01.2026	Kërkesë për detajimin e procedurës së aplikimit për ndërhyrje në pasuri kulturore, zona e Konispolit.	12.01.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me email në adresën zyrtare të IKTK në datën 06/01/2026, me anë të së cilës kërkoni informacion mbi procedurën e aplikimit për ndërhyrje në banesën tuaj në qytetin e Konispolit, Ju bëjmë më dije se:</p> <p>Pas verifikimeve të kryera, si dhe nga relacioni i mbajtur nga DRTK, Vlorë, rezulton se "Banesa e Vëllezërve Koqini" në qytetin e Konispolit është shpallur Monument Kulture i kategorisë së I-rë nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës) me Aktin nr. 266/1, datë 16.02.1979. Kjo banesë ndodhet në qendër të lagjes Shehat me pamje nga veriu.</p>	E plotë	Jo

			<p>Në bazë të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Ligjore dhe Muzetë”, i ndryshuar, nenet 38, 77 dhe neni 80, si dhe referuar VKM - së nr. 458, datë 31.07.202025 “Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme “Ansambël Arkitektonik Urban” të një zone në qytetin e Konispolit, përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të tij dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, kërkesa është objekt shqyrtimi në KKTKM;</p> <p>Në zbatim të VKM - së nr. 458, datë 31.07.202025, neni 12, pika 3: <i>Projektet për rikonstruksionin/ rindërtimin/ ri trajtimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja brenda “Ansambli arkitektonik urban” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja ose nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.</i></p> <p>Për sa më sipër, për shqyrtimin e kërkesës në këshillat përkatës pranë IKTK-së është i nevojshëm aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar <a href="http://www.e-albania.al">www.e-albania.al</a>, në kategorinë “Aplikim për Leje për Ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale dhe Bonus Rijetësimi – Monument Kulture i kategorisë I-rë”, sipas linkut: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702</a></p> <p>Për sa i përket dokumentacionit të detyrueshëm për aplikim në shërbimin “Monument Kulture i kategorisë së I-rë” ju lutem referohuni në listën e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Deklarata e përgjegjësisë profesionale;</li> <li>2. Prokurë/Autorizim për aplikuesin;</li> <li>3. Vërtetim pronësie dhe kartelë pasurie e rifreskuar 3 muajt e fundit;</li> <li>4. Projektet teknike dhe relacionet përkatëse në formatin pdf dhe të nënshkruar nga personi fizik/juridik të licencuar në restaurim (Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhornuar të hartës së parcelës/ave, Vendndodhja me koordinata gjeografike, Ortofoto);</li> <li>5. Specifikime Teknike;</li> <li>6. Grafiku i Punimeve;</li> </ol>		
--	--	--	--	--	--

				<p>7. Preventiv;</p> <p>8. Prezantim projekti në powerpoint;</p> <p>9. Projekti i plotë në format të editueshëm (AutoCad, Revit, Archicad etj.).</p>		
3	07.01.2025	Informacion mbi dokumentacionin arkivor per objektin “ <b>Kulla e Elmaz Dezhgiu</b> ”, <b>Guri i Bardhë, Dibër</b> , për përdorim akademik.	13.01.2025	<p>Në vijim të dërgimit të faturës për arkëtim dhe përcjelljes së mandat-pagesës, ju vëmë në dispozicion, bashkëlidhur në linkun përkatës, me dokumentacionin arkivor për objektin pasuri kulturore “Kulla e Elmaz Dezhgiu”, Klos, referuar kërkesës suaj.</p> <p><a href="https://www.transferxl.com/it/download/08SHrtmjvQNk6">https://www.transferxl.com/it/download/08SHrtmjvQNk6</a></p>	E plotë	2000 lekë
4	07.01.2026	<p>1. Cili është statusi aktual i projektit të restaurimit të ish-godinës së Radio Tiranës dhe cilat procedura janë përfunduar deri tani?</p> <p>2. Cili është numri dhe data e vendimit me të cilin KKTKM miratoi projektin dhe cilat kushte specifike janë vendosur në atë vendim? Ju lutem ma vendosni nw dispozicion.</p> <p>3. Cilat ndërhyrje janë miratuar konkretisht dhe cilat elemente origjinale duhet të ruhen detyrimisht?</p> <p>4. A mund të vihet në dispozicion përmbledhja teknike dhe dokumentacioni publik i projektit (relacion, studime, grafika)?</p> <p>5. Pse punimet nuk kanë nisur ende në terren dhe cilat janë pengesat kryesore të identifikuara (procedurale, financiare, teknike)?</p> <p>6. A janë ndryshuar afatet fillestare të nisjes/përfundimit dhe cilat janë afatet e reja të miratuara?</p> <p>7. Çfarë inspektimesh janë kryer nga IKTK/KKTKM pas miratimit të projektit dhe cilat janë gjetjet kryesore?</p>	29.01.2026 (me shtyrje afati).	<p>Ne vijim te kerkeses suaj, ju bejme me dije se:</p> <p><b>1. Cili është statusi aktual i projektit të restaurimit të ish-godinës së Radio Tiranës dhe cilat procedura janë përfunduar deri tani?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Projekti i restaurimit i miratuar me vendim te KKTKM, akoma nuk eshte zbatuar, pasi afati kohor i parashikuar për restaurimin (vlefshmeria e vendimit ka përfunduar). Nevojitet nje aplikim i ri ne sistem e-leje me qellim rifreskimin e vendimit te KKTKM apo rishikimin e afatit;</li> </ul> <p><b>2. Cili është numri dhe data e vendimit me të cilin KKTKM miratoi projektin dhe cilat kushte specifike janë vendosur në atë vendim? Ju lutem ma vendosni nw dispozicion.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ne mbledhjen e datës 06.07.2023, KKTKM vendosi miratimin e projektit "Ndërhyrje restauruese në objektin: Instituti i Kulturës Popullore, II-102, në pronësi të Z. Rolandi Manushi Rruga “Kont Urani” – Tiranë". Vendim të cilin e gjeni të publikuar ne faqen web sipas linkut: <a href="https://iktk.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Vendim-nr.-381-date-06.07.2023-Rolandi-Manushi.pdf">https://iktk.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Vendim-nr.-381-date-06.07.2023-Rolandi-Manushi.pdf</a>;</li> </ul> <p><b>3. Cilat ndërhyrje janë miratuar konkretisht dhe cilat elemente origjinale duhet të ruhen detyrimisht?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nërhyrjet e miratuara me vendimin nr. 381, date 06.07.2023, jane te pasqyruara dhe te detajuara, ne projektin te cilin e gjeni bashkelidhur;</li> </ul> <p><b>4. A mund të vihet në dispozicion përmbledhja teknike dhe dokumentacioni publik i projektit (relacion, studime, grafika)?</b></p>	E plotë	Jo

		<p>8.Cili është vlerësimi aktual i riskut për monumentin dhe a rekomandohen ndërhyrje emergjente konservuese deri në nisje të restaurimit?</p> <p>9. Cila është kostoja e miratuar në projekt (preventivi), a është rishikuar dhe përse?</p>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkelidhur gjeni te gjithë paken e plote te ketij projekti.</li> </ul> <p><b>5. Pse punimet nuk kanë nisur ende në terren dhe cilat janë pengesat kryesore të identifikuar (procedurale, financiare, teknike)?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Punimet nuk kane filluar si rezultat i perfundimit te afatit kohor te vendimit te KKTKM, pasi referuar dispozitave te ligjit nr. 27/2018 “Per trashegimine kulturore dhe Muzete” afati eshte 1 vit. Punimet nuk mund te rinisin pa u miratuar nga Keshilli Kombetar i Trashegimise Kulturore Materiale, shtyrja e afatit.</li> </ul> <p><b>6. A janë ndryshuar afatet fillestare të nisjes/përfundimit dhe cilat janë afatet e reja të miratuara?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Akoma nuk ka afate te reja te miratuara. Nuk rezulton të ketë ardhur në Sportelin Unik një aplikim "Për shtyrje afati të punimeve" për të njëjtin objekt.</li> </ul> <p><b>7. Çfarë inspektimesh janë kryer nga IKTK/KKTKM pas miratimit të projektit dhe cilat janë gjetjet kryesore?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>IKTK nuk ka kryer inspektime pas miratimit te projektit.</li> </ul> <p><b>8. Cili është vlerësimi aktual i riskut për monumentin dhe a rekomandohen ndërhyrje emergjente konservuese deri në nisje të restaurimit?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pas komunikimeve me Drejtorine Rajonale te Trashegimise Kulturore, Tirane, e cila e administron kete pasuri nga ana territoriale, Monumenti në fjalë është i klasifikuar me nivel rrezikshmërie nr. 1, që nënkupton se gjendja e objektit paraqitet e mirë.</li> </ul> <p><b>9. Cila është kostoja e miratuar në projekt (preventivi), a është rishikuar dhe përse?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kostoja eshte e pasqyruar ne preventivin e punimeve qe e gjeni bashkelidhur dhe nuk eshte rishikuar deri tani pasi nuk ka nje aplikim te ri apo vendimmarje tjeter te KKTKM.</li> </ul>		
5	07.01.2026	Vënie në dijeni për procedurat ligjore për publikimin dixhital dhe miratimin e dokumentimit 3D të monumentit	08.01.2026	Në vijim të kërkesës tuaj, dërguar me e-mail në adresën zyrtare të IKTK-së, në datën 07.01.2026, mbi projektin për dokumentimin 3D dhe prezantimin virtual të monumenteve të kulturës, ju bëjmë me dije se:	E plotë	Jo

				<p>Kërkesa juaj, e shoqëruar me një prezantim të projektit duhet të drejtohet për vlerësim në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (në vijim MTKS) duke ndjekur procedurat përkatëse. Prezantimi i projektit duhet të detajohet me listën e objekteve me status pasuri kulturore, të tregojë kush është qëllimi i këtij projekti dhe nëse ka qëllime fitimprurëse.</p> <p>Për sa i përket procedurave ligjore për publikimi digjital, ju mund të vijoni me të, vetëm pasi të keni marrë lejen përkatëse në MTKS, dhe në rastin e veprave të artit pasi të keni marrë dhe autorizimin nga autori i veprës apo trashëgimtari i ligjshëm.</p>		
6	08.01.2026	Kerkese per materiale arkivore te objektit "Ura e Katiut në fshatin Bënjë".	09.01.2026	<p>Në vijim të kërkesës Suaj drejtuar në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 5, datë 27.8.2025 “Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga instituti kombëtar i trashëgimisë kulturore” (pika 5), ju përcjellim bashkëlidhur, nëpërmjet linkut përkatës, kopje digjitale të dokumentacionit arkivor të plotë të dosjes teknike për pasurinë kulturore “<b>Ura e Katiut</b>”, Bënjë, Përmet.</p> <p>Dokumentacioni përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rilevime arkitektonike;</li> <li>• Relacione teknike dhe përshkrimore;</li> <li>• Projekt restaurimi, viti 2015;</li> <li>• Foto historike.</li> </ul> <p><a href="https://www.transferxl.com/it/download/08j31zSp8trfDd">https://www.transferxl.com/it/download/08j31zSp8trfDd</a></p>	E plotë	Jo
7	13.01.2026	<p>Kerkese per dokumentacion arkivor per objektet:</p> <p>1. Banesë tip vilë 3 kate – Rruga “Sotir Peçi”, Tiranë, Monument Kulture, Kategoria I</p> <p>2. Banesë tip vilë 3 kate – Rruga e Durrësit, Tiranë, Monument Kulture, Kategoria I</p> <p>3. Ministria e Mjedisit Rr. e Durrësit Institucion Sheteror) Monument Kulture Kategori I. Dokumentacioni i kërkuar përfshin, por nuk kufizohet në:</p> <p>- dosjet e shpalljes monument kulture,</p>	14.01.2026	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, drejtuar në adresën elektronike të IKTK-së, dhe mbështetur në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 5, datë 27.8.2025 “Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga instituti kombëtar i trashëgimisë kulturore” (pika 5), ju bëjmë me dije sa më poshtë:</p> <p>Nga verifikimet e kryera në fondet arkivore të Arkivit Teknik, lidhur me objektet në studim, disponojmë dokumentacion arkivor (projekt) për objektin “<b>Vilë banimi 3 kate – Rruga e Durrësit, Tiranë</b>” monument kulture kat. II si dhe aktin ligjor të deklarimit pasuri kulturore.</p> <p>Lidhur me dy objektet e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Banesë tip vilë 3 kate – Rruga “Sotir Peçi”, Tiranë;</li> </ul>	E plotë	Jo

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- projektet historike dhe arkitekturore,</li> <li>- planimetritë, prerjet dhe fasadat origjinale,</li> <li>- dokumentet e ndërhyrjeve të mëparshme,</li> <li>- aktet e restaurimeve, konsolidimeve apo rehabilitimeve të kryera,</li> <li>- çdo material grafik, fotografik apo teknik që gjendet në fondet e Arkivit të IKTK-së.</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria e Mjedisit – Rruga e Durrësit, Tiranë nuk disponojmë dokumentacion teknik, fotografik apo përshkrimor, por vetëm aktet ligjore të deklarimit si pasuri kulturore (monument kulturre kat II). Sa më sipër, ju dërgojmë bashkëlidhur kopje digjitale të materialeve arkivore që disponojmë në kuadër të hartimit të projekteve restauruese. <a href="https://www.transferxl.com/it/download/08vbMWyn0SHVvd">https://www.transferxl.com/it/download/08vbMWyn0SHVvd</a></li> </ul>		
8	23.01.2026	Kerkese nëse Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) mund të na rekomandoj profesionistë vendas shqiptarë ose zyra të specializuara në konservimin dhe restaurimin arkitektonik, të cilët potencialisht mund të bashkëpunojnë për organizimin e konkursit nga “Miralles Tagliabue - EMBT Architects” një firmë ndërkombëtare arkitekturore, që aktualisht po përgatit një propozim për konkursin arkitektonik për Rehabilitimin e Pallatit të Kongreseve në Tiranë.	27.01.2026	<p>Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), administron regjistrat e subjekteve/shoqërive të licencuara për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore si dhe veprimtari në fushën e arkeologjisë.</p> <p>Këto licencime bëhen sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me vendimmarrje të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe lëshohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.</p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, IKTK publikon këto regjistra si dhe përditësimin e tyre sa herë është e nevojshme në faqen zyrtare të institucionit, konkretisht:</p> <p>Për veprimtaritë ndërhyrëse në pasuritë kulturore <a href="https://iktk.gov.al/regjistri-i-licencave-ne-veprimtari-nderhyrese-ne-pasuri-kulturore/">https://iktk.gov.al/regjistri-i-licencave-ne-veprimtari-nderhyrese-ne-pasuri-kulturore/</a>;</p> <p>Për veprimtaritë arkeologjike <a href="https://iktk.gov.al/regjistri-i-licencave-ne-veprimtari-arkeologjike-dhe-veprimtari-arkeologjike-nenujore/">https://iktk.gov.al/regjistri-i-licencave-ne-veprimtari-arkeologjike-dhe-veprimtari-arkeologjike-nenujore/</a>;</p>	E plotë	Jo
9	04.02.2026	Informacion për banesën me kod arkivi teknik K 097, me emërtimin Banesa e Kozma Shyti, lagja Kala, Berat,	06.02.2026	<p>Në vijim të kërkesës suaj, dërguar në adresën elektronike të IKTK-së, dhe në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, ju bëjmë me dije sa vijon:</p> <p>Nga verifikimi i fondeve arkivore pranë Arkivit Teknik rezultoi se nuk disponohet dosje teknike apo dokumentacion fotografik për objektin pasuri kulturore të kategorisë II “Banesa e Kozma Shyti”, e ndodhur në lagjen “Kala”, Berat, me kod K-097.</p>	E plotë	Jo

10	09.03.2026	Kerkese per informacion mbi hapat që duhet të ndjekim për aplikimin për rinovim të licencës;	10.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, dërguar me email në adresën zyrtare të IKTK-së në datën 09.03.2026 "<i>Kërkesë për informacion mbi procedurën e rinovimit të licencës së restaurimit</i>", Ju informojmë se,</p> <p>Pë rinovimin e Licencës për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Projektim (P) dhe Licencës në Zbatim (Z) ju duhet të aplikoni në portalin <b>e- albania</b> në kategorinë <b>Licencë për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale</b> sipas linkut:</p> <p><a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14379">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14379</a></p> <p>Për sa i përket dokumentacionit të nevojshëm, i cili duhet të ngarkohet në sistem gjatë aplikimit për rinovimin e licencës në Projektim (P) dhe të licencës në Zbatim (Z), ju lutem referohuni në listën e mëposhtme:</p> <p><i>a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit, i cili gjenerohet në sistem gjatë aplikimit;</i></p> <p><i>b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;</i></p> <p><i>c) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik;</i></p> <p><i>ç) kontratën e punësimit ndërmjet përfaqësuesit ligjor të personit juridik dhe drejtuesit teknik të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të hartuar përpara noterit;</i></p> <p><i>d) vetëdeklarimin nga drejtuesi teknik, për:</i></p> <p><i>i. gjendjen gjyqësore dhe penale;</i></p> <p><i>ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;</i></p>	E plotë	Jo

				<p>iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë publikë të tjerë.</p> <p>Gjatë aplikimit, duhet të shkarkoni mandatin dhe të kryeni pagesën sipas tarifave. Më pas mandatin e paguar duhet t'a ngarkoni në sistem bashkë me dokumentacionin.</p> <p>Afati i shqyrtimit të aplikimit dhe verifikimit të dokumentacionit deri në vendimmarrje në organet kolegjiale është 60 ditë.</p> <p>Për sa më sipër, sjellim në vëmendjen Tuaj se, në rastet kur afati i licencës ka mbaruar apo mbaron para se subjekti të pajiset me licencë të re, ky i fundit nuk duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën e veprimtarisë për të cilën ishte licencuar.</p> <p>Me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese pranë Sekretarisë Teknike, në IKTK.</p>		
11	17.03.2026	Kerkese per dokumentacion arkivor	18.03.2026	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, drejtuar në adresën elektronike të IKTK-së, dhe mbështetur në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, ju përcjellim bashkëlidhur, nëpërmjet linkut përkatës, kopje digjitale të dokumentacionit arkivor të plotë të dosjes teknike nr. 453 për pasurinë kulturore “Manastiri i Shën Mërise, Goranxi”, Gjirokaster/ Manastiri i Ravenës.  <a href="https://www.transferxl.com/it/download/08j8Nd0LVcJD7b">https://www.transferxl.com/it/download/08j8Nd0LVcJD7b</a></p>	E plotë	Jo
12	19.03.2026	Kerkese per venien ne dispozicion te kontakteve te pronarëve për disa nga kullat monument kulture në Has.	30.03.2026	<p>Ju bejme me dije se IKTK nuk disponon kontakte te pronareve te kullave, referuar kerkeses suaj.</p>	E plotë	Jo